



Ekzekutohet me 15 plumba, policia: 35-vjeçari me precedentë kriminalë

AKTUALITET On Pri 10, 2017



Shperndaje



Të tjera detaje janë zbardhur në lidhje me viktimën që humbi jetën për shkak të një atentati me armë zjarri mbrëmjen e kaluar në Vlorë. Të blutë informojnë se viktima Elidon Mehmeti njihej nga policia shqiptare si person me precedent kriminalë, i përfshirë në fushën e narkotikëve.

Gjithashtu, nga hetimet e kryera ka rezultuar se ky shtetas është arrestuar në shtetin italian për “Trafikim të Lëndëve Narkotike”.

35-vjeçari u ekzekutua me breshëri

kallashnikovi mbrëmjen e djeshme në qytetin e Vlorës, rreth orës 23:00, në rrethrotullimin e Skelës.

Ai u ekzekutua brenda makinës së tij tip “Ford”, me targa AA 709 HM, teksa po lëvizte në drejtim të banesës së tij. Atentati është bërë nga persona ende të pidentifikuar, të cilët qëlluan me armë zjarri nga një tjetër makinë.

Dyshohet se Mehmeti është ndjekur nga autori dhe është qëlluar në një moment kur makina, për shkak edhe të punimeve që po bëhen në zonë, ka qenë në limitet e shpejtësisë.

Pasi ka ikur për rreth 50 metra me makinën ndezur, mjeti është ndalur dhe 35--vjeçari ka tentuar të dalë për të kërkuar ndihmë.

Breshëria ka terrorizuar banorët e paktë që janë gjendur afër vendit të ngjarjes në ato momente.

Kalimtarët janë afruar për ta ndihmuar ndërsa autoambulanca, e cila ka mbërritur në një kohë të shpejtë, e ka shoqëruar në spital. Deri në këto momente, Policia ka shoqëruar 8 persona me të cilët po punohet për zbardhjen e ngjarjes.

Vijojnë hetimet për dokumentimin e plotë ligjor të ngjarjes dhe për arrestimin e autorëve.



← POSTIMI I MËPARSHËM

Meshkuj, ja disa këshilla për t'u dukur më atraktivë tek femrat

POSTIMI TJETER →

Bebeja shokon të gjithë, lind me flokë ngjyrë ari të bardhë. Cila është arsyeja? (Foto)

YOU MIGHT ALSO LIKEMe Shume Nga Autori

AKTUALITET

Naftë pa taksa për fermerët, përfitojnë ata që kanë tokë e që janë të regjistruar

AKTUALITET

Urdhri i rremë në rrjete sociale, ministria e Shëndetësisë e hedh poshtë: Nuk do të...

AKTUALITET

Ndoti ajrin duke hedhur mbetjet, vihet nën hetim administratori i një firme në...

AKTUALITET

U kap në Spanjë para disa ditësh/ Gjykata lë në burg Gentian Markun, pjesë e...

AKTUALITET

Arsenal armësh në Divjakë e Mallakastër, arrestohen dy persona

AKTUALITET

Sekuestrohen veshje firmato fallso në Itali, policia: Vijnë nga Shqipëria

< PREV

NEXT >

PERGJIGJU

Adresa juaj e-mail nuk publikohet

Komenti juaj

Emri Juaj *


e-maili juaj *

Website i juaj


☐ Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

POST COMMENT

LAJMET MINUTE PAS MINUTE



Horoskopi per ditën e sotme, 17 tetor 2020




Tatuazhi simbolik i Xhensila Myrtezaj: Kjo është lutja ime!




Mozik dhe Loredana janë bashkë?! Çfarë thotë Getinjo




Miss-i shqiptar tregon si abortoi në moshë të vogël: U...




Theu rregullat e pandemisë, ndalohet nga policia këngëtarja...




Një tjetër lojtar i Kosovës konfirmohet pozitiv me COVID-19




Fotoja e saj nudo bëri xhiron në rrjet, zbulohet me kë ishte...




Fotoja që bëri xhiron e rrjetit, foshnja i heq maskën mjekut




Liqeni me fuqi shpërthyesë është kthyer në rrezik për...



Horoskopi per ditën e sotme, 16 tetor 2020



Shokon Tiziano Ferro në dokumentarin për jetën: Isha i...



“Po bëj seksin më të mirë të jetës”, e reja lidhet me...